



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Flori Rexhepi	05.12.2023	18.12.2023	2023/0970

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.12.2023, OE “Gezime S. Gashi B.I.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0970, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “DHF Company SHPK”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me pelet” me nr. të prokurimit: "616-23-6338-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure të hapur, të negociuar, të kufizuar, lloji i kontrates: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 438,000.00 €.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 21.06.2023, Njoftim për Informata shtese ose përmirësim i gabimit: 21.06.2023, data e hapjes së ofertës: 02.08.2023, data e vendimit për dhënien e kontratës: 16.11.2023, data e njoftimit të me letër standarde: 16.11.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 56 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

Neni 8 i Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik; dhe Vendimin e OSHP-së me nr. OSHP: 2023/0733

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale 1. Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Kopja e certifikates se regjistrimit të biznesit me llojin e veprimtarive të regjistruara
--	-----------	--	---

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar <u>n/a</u>	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> <u>n/a</u>
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional 1.Operatori duhet te ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka realizuar kontrata për furnizime të ngjashme (lende djegese) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të këtij Njoftimi për Kontratë jo me pak se 400.000,00. 2. Operatori Ekonomik duhet të posedojë Kamion me autovinç (vet ngarkues dhe vet shkarkues) qe është i domosdoshme për realizimin e projektit. 3. Operatori Ekonomik duhet te ofroj deklarate me shkrim gjate ofertimit se posedon produktin e kerkuar prej 60% të sasise ne depun e tij.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje e furnizimeve. 2. Librezen e qarkullimit për kamionin me autovinç. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytezimin e Kamionit me autovinç, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per pajisjen e larte cekur. 3. Deklaratë me shkrim e vulosur dhe e nenshkruar se posedon produktin e kerkuar prej 60% të sasise.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues eshte i pergjegjshem.

OE i rekomanduar per kontrate eshte i pergjegjshem.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimit të PSH-se nr. 733/23

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - Gëzime S. Gashi B.I.

Pretendimi nr.1

OE ankues, si palë e pakënaqur, ka parashtruar ankesë ne OSHP, me pretendimin se AK-ja nuk e ka respektuar e vendimin nr. 733/23 dhe kryesisht sikurse ne ankesën e pare i konteston kontratat dhe referencat e OE të rekomanduar për kontrate për të cilat deklaron se janë fiktive.

Eksperti shqyrtues sqaron se pas vendimit të PSH-se nr. 733/23, AK-ja e ka kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me pelet me nr. të prokurimit: 616-23-6338-1-1-1, ku ka kërkuar sqarime për kontratat dhe referencat e OE te rekomanduar për kontrate.

Ne përgjigje OE i rekomanduar për kontrate i ka dorëzuar kontratat, referencat dhe disa qarkullime bankare me operatore ekonomik privat (kontrate e lidhur ne mes të OE te rekomanduar për kontrate me OE Ahmetaj Group, pastaj me OE Jusaj Metal, Lira -M etj).

OE ankues ne ankesën e tij i konteston veç e veç kontratat, referencat dhe qarkullime bankare, për të cilat pretendon se kontratat e OE të rekomanduar për kontrate janë fiktive vetëm si dëshmi për ta mbuluar kërkesën e dosjes se tenderit.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar kontratat dhe referencat e OE të rekomanduar për kontrate të dorëzuara ne platformën e E-Prokurimit gjate fazës se rivlerësimit të ofertave me c’rast AK-Komuna e Prishtinës pas analizimit te deshmit e ka rekomanduar për kontrate, eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja, nuk e ka përfunduar procesin e vlerësimit të dëshmime sipas nenit 59 të LPP-se, sepse eksperti shqyrtues gjate analizimit të kontratave ka vërejtur se kontrata e lidhur me datën: 07.12.2017 ne mes të OE DHF dhe OE Lira – M, në pjesën hyrëse të kontratës thuhet:

E lidhur ne Pejë, me date: 07.12.2017, ndërmjet palëve kontraktuese ne vijim:

DHF Company Shpk, me numër unik identifikues **810746670** dhe Lira – M

KONTRATË PËR FURNIZIM ME LANDE DJEGESE

E lidhur në Pejë, me datën 07.12.2017, ndërmjet palëve kontraktuese në vijim:

1. **DHF COMPANY SH.P.K.**, me numer unik identifikues 810746670, me scli në adresën rruga UCK, , Pejë, e përfaqësuar nga z. Hysen Jusaj, Drejtor Menaxhues (më tutje referuar si “Shitësi”);
2. **LIRA-M NPT**, me scli në adresën - Decan,(më tutje referuar si “Blerësi”).

Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne ligjin 06/L-016, sqaron se ne vitin 2017 nuk ka pasur numra unik identifikues, kjo vërtetohet nga fakti se ne paragrafin 4 të nenit 266 te këtij ligji thuhet: Gjatë periudhës tranzitore tre (3) vjeçare, ARBK obligohet të pajisë të gjitha Shoqëritë Tregtare ekzistuese me numër unik. Ligj i cili ka hyr ne fuqi me datën: 24.05.2018. Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se procesi i vlerësimit të këtyre dëshmime nuk është bere ne harmoni të plot me nenin 59 dhe 72 të LPP-se. Poashtu lidhur me këtë çështje eksperti shqyrtues vlerëson se ka edhe kontrata tjera të cilat janë para datës kur OE i rekomanduar për kontratë është pajisur me certifikat të re.

Gjithashtu sipas Udhëzimit Administrative Nr. 01/2019 të Qeverise se Republikës se Kosovës të datës: 03.04.2019 janë përcaktuar afatet për transfer të numrave të bizneseve, konkretisht ne nenin 11 të këtij Udhëzimi Administrative.

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi i OE ankues sepse është dashur të verifikohet gjendja ne të cilën është pasqyruar kontrata se si operatori ekonomik e ka pasur numrin unik ne vitin 2017.

Poashtu edhe disa kontrata tjera janë para datës se hyrjes ne fuqi të Udhëzimit Administrative Nr. 01/2019 me te cilin janë obliguar operatorët ekonomik ti ndërrojnë numrat unik.

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number
810746670

Shënim me rëndësi / Important Note / Vazan podatak

; Numri mëparshëm i biznesit është NRB: 70908263 , me zbatimin e ligjit për numrin unik të identifikues të biznesit ka këtë numër NUI: 810746670

Informata plotësuese / Additional Information Note / Dodatna informacija

Rr. "Arbënor e Astrit Dehari" p.n, Lagja e Spitalit 10000 Prishtinë
Data / Date / Datum: 18/05/2022 10:45

Tel1: 038 200 36 562
Tel2: 038 200 36 573

Faqe 2 nga 17

Eksperti shqyrtues, mbi bazën e të dhënave në dëshmit e prezantuara vlerëson se është e nevojshme të bëhen verifikime të dëshmive sepse janë kontradiktore dhe këtë e vërteton fakti se nga shtate (7) referenca të dorëzuara gjashtë (6) prej tyre mbajnë datën e lëshimit: 06.06.2023 dhe vetëm njëra është me datën: 07.06.2023.

Në kontratat e prezantuara konkretisht në kontratën e vitit 2017, në nenin ku flitet për kohëzgjatjen e kontratës, thuhet se marrëveshja është për tri vite me mundësi vazhdimi edhe për 3 vite tjera dhe nuk ka asnjë dëshmi se kontrata është vazhduar me tutje, ndërsa referenca është lëshuar me datën: 06.06.2023.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Gëzime S. Gashi B.I.**

Florije Rexhepi

